



02/Nr 6746 /2018

Data: 09.08. 2018

## PROCESVERBAL I KKSb-së

Nga mbledhja e shtatë - VII- për vitin 2018 mbajtur me datë: 27.07.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Shpend Bela** (përfaqësues i stacionit policor), **Vahid Hyseni** (përfaqësues i policisë kufitare –vija e gjelbërt), **Menduh Vlasi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rini dhe sport), **Ali Vishi** (përfaqësues i FSK-së), **Hyriete Isufi** (kryesuese e komitetit për komunitete), **Nusret Shiti** (përfaqësues i këshillit të bashkësisë islame në Han të Elezit), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Isa Shkreta** (përfaqësues i E.V.S.B), **Amir Bushi** (përfaqësues nga zyra për barazi gjinore), **Qamil Kalisi** (përfaqësues i Hendikosit).

Takimin e kryesoj kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Të ndryshme.

**Rufki Suma** pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Rufki Suma** a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

**Rufki Suma** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shpend Bela** gjatë këtij muaji kemi pas 7 (shtatë) raste. Planet jemi duke u mundura me i realizuar me aq kapacitet që kemi. Ka hyrë në fuqi edhe task forca për parandalim të aksidenteve në komunikacion. Janë shqiptuar 115 tiketa në trafik. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

**Vahid Hyseni** gjatë këtij muaji kemi pas 2 (dy) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

**Rufki Suma** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

### 3. Të ndryshme.

**Rufki Suma** është dukuri çështja gjuajtjes me armë nëpër ahengje të ndryshme por kemi problem me mos funksionim të sistemit të drejtësisë për shkak se policia vetëm e ka të drejtën me përcjell me procedurë të rregullt. Zhvillimi i punimeve të kompanisë “Bektelenka” ka shkaktuar probleme vazhdimisht në ndotje të ambientit dhe vazhdimisht kemi reaguar. Udhëzimi administrativ i jep kompetencë policisë që pa inspektorët komunal mund të shqipton gjoja mandatore ndaj personave që hedhin mbeturina. Fatmirësisht me çështje të zjarrit nuk kemi pas probleme. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hyriete Isufi** vërejtje kam pas nga anëtarët e komitetit për komunitete sepse po bëhet pak për çështjen e qenve endacak . Te parkingu i cili është afër shkollës fillore “Ilaz Thaçi” të vendoset një rampë në mënyrë që të vërehet se kur qarkullon kamioni. Me kërkuar nga kompania “Bektelenka” që me u pastruar asfalti mirë.

**Rufki Suma** kohët e fundit është potencuar që Qeveria i ka ndarë mjetet financiare dhe është filluar trajtimi i qenve endacak por ende nuk ka diçka konkrete. Sa i përket pastrimit të rrugës nga kompania “Bektelenka” vazhdimisht kemi dhënë vërejtje dhe reagime. Për çështje të kamionëve policia duhet t’i bëhet vërejtje drejtë për drejtë kompanisë “Sharrcem” se po e rrezikon komunikacionin.

**Amir Bushi** është mirë që prej orës 7:30 e deri në ora 8:00 asnjë kamion mos me lëvizë për arsye se në atë kohë nxënësit shkojnë në shkollë. Nga ora 12:00 deri në ora 13:00 kamion mos me lëvizë sepse nxënësit lëshohen nga shkolla dhe në atë kohë nxënësit të cilët i ndjekin mësimet pasdite shkojnë në shkollë. Nga ora 16:00 deri në ora 17:00 mos me lëvizë kamionët sepse nxënësit të cilët i ndjekin mësimet pas dite lëshohen nga shkolla. Pavarësisht që qëndron patrulla e policisë kamionët vazhdojnë qarkullimin. Parku i cili është në oborrin e shkollës fillore “Ilaz Thaç” është shkatërruar gati se krejt për shkak të punimeve nga kompania “Bektelenka”


**Refet Kalisi** çdo vërejtje që ka ardhur në komunë nga qytetarët ju kemi drejtuar me shkrim kompanisë “Bektelenka”. Për çështjen e kamionëve të kompanisë “Sharrcem” duhet të bisedojmë në mënyrë që ata ta gjejnë një vend më të përshtatshëm dhe nuk është e arsyeshme me ja ndërprerë kamionët sepse është biznes.

**Nusret Shiti** banorët që janë mbi hekurudhë, banorët e fshatit Dimcë dhe Paldenicë me pas të drejtë që minimum së paku një herë në ditë me i pastruar veturat sepse pjesa më e dëmtuar nga kompania “Bektelenka” është nga dheu i bardhë deri në Han të Elezit.

**Isa Shkreta** problem po kemi te kufiri për shkak të kolonës dhe policia kufitare potencon se është kompetencë e stacionit policorë.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 30 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi  
Avni Bushi



Kryetari i Komunës  
Rufki Suma

